

RAPORTI VLERESIMIT

TE NDIKIMIT NE MJEDIS Per aktivitetin e Drejtorise se Sherbimit Spitalor Sarande

Vendodhja e ushtrimit te aktivitetit: Lagjja nr.3, Rruga "ONHEZMI", Sarande

Subjekti: Drejtoria e Sherbimit Spitalor Sarande

Hartimi Raportit nga : "VIELF STUDIO" shpk



Tirane 2015

PERMBAJTJA

1- HYRJE

- 1.1 Informacion per qellimin e vnm dhe metodiken e zbatuar*
- 1.2 Pershkrim i qellimit te VNM*
- 1.3 Objektivat e VNM*
- 1.4 Legjislacioni Mjedisor ne Shqiperi*
- 1.5 Profili i subjektit*

2- PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

- 2.1 Qellimi i zhvillimit te aktivitetit*
- 2.2 Objektivat e zhvillimit te aktivitetit*
- 2.3 Vendodhja ku ushtrohet aktiviteti*
- 2.4 Repartet e spitalit*

3- PERSHKRIMI I RAJONIT

4- VLERESIMI I NDIKIMEVE

- 4.1 Ndikimet e mundshme ne shendetin e njerezve*
- 4.2 Ndikimet ne toke*
- 4.3 Ndikimet ne uje*
- 4.4 Ndikimet ne ajer*
- 4.5 Ndikimet nga zhurmat*
- 4.6 Ndikimet ne flore dhe faune*
- 4.7 Ndikimet ne klime*
- 4.8 Ndikime mbi trashegimine kulturore*
- 4.9 Ndikimet me natyre nderkufitare*

5- MASAT PER ELEMENIMIN/ ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

- 5.1 Masat per Shkarkimet ne uje*
- 5.2 Masat per Depozitimet ne toke*
- 5.3 Masat ndaj zjarrit*
- 5.4 Masat ndaj zhurmave*
- 5.5 Masat estetike dhe ekologjike*

6- PROGRAMI I MONITORIMIT

7- PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE

8 -KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1-HYRJE

Mjedisi është bashkësia e ndërveprimeve të përberësve biotike dhe jobiotike që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në tokë duke përfshirë mjedisin biofizik natyror të ajrit, tokës, ujërave shëndetin e njeriut, vlerat dhe trashëgimë kulturore. Pra mjedisi është një bashkëveprim i faktoreve natyror dhe shoqëror. Faktoret natyror dhe shoqëror të mjedisit ndikojnë drejtperdrejtë në jetën e njeriut. Për të mbijetuar kohës njeriut i është dashur të përshatet mjedisit ku jeton dhe ta ndryshoj atë në mënyrë që ta bëjë të përshatshëm për veten e vet. Por pikërisht në këto pike shfaqen edhe problemet e para të mjedisit.

Kështu përparimi zhvillimi i shkencës dhe i teknologjisë por nga ana tjetër shfrytëzimi pa kriter i mjedisit, të gjitha këto krijuan dhe problemet e para midis njeriut dhe mjedisit. Zhvillimi i teknologjisë bëri që vertet jeta të përmirësohet dhe njerezit të jetojnë më mirë por nga ana tjetër solli edhe shumë probleme për mjedisin si përshembull ndotja e ajrit, prerja e pyjeve etj.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk është i rëndësishëm vetëm për njerezit por është thelbësor dhe i nevojshëm për të gjitha qeniet në tokë. Njerezit duhet të kuptojnë se si përdorimi i burimeve mjedisore dhe përfitimet që vijnë nga ato të mos demtohen por të jete e mundur të përfitohet sot dhe në të ardhmen.

Termi mjedis dhe burime natyrore përdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qartë që i perkufizon. Burimet natyrore i referohen burimeve të tokës, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrit që rrethon tokën, çdo gjë që rritet në tokë apo det si dhe burimet që gjenden nëntokë si psh mineralet. Mjedisi është me gjithpërfshirës çdo gjë që na rrethon. Zhvillimi i njerezimit dhe i industrisë është shoqëruar edhe me pasojat në mjedis, përçindja e dioksidit të karbonit në atmosferë është rritur rreth tridhjetë përçind që nga fillimi i Revolucionit Industrial.

Thjesht duke përdorur burimet natyrore në rrezikojmë në mbipërdorimin dhe shpërrimin e tyre. Shpërrimi i burimeve natyrore është një nga problemet thelbësor të çrregullimit të mjedisit. Në të përfshihet shpërrimi i ujit, mineraleve përfshirë dhe lëndet fosile si dhe shumë burime të tjera.

Në mënyrë që të shmangim këto probleme njerezimi duhet të mesoj se si të menaxhohen burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme. Pra zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore nuk është gjë tjetër veçse përdorimi i tyre në mënyrë ekonomike nga brezat e sotëm për të lënë këto burime të përdoren edhe nga brezat që do të vijnë.

Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqërohet edhe me impakt në mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit të mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor. Kemi dy tipe të impaktit mjedisor

- shpërrimi i burimeve

- ndotja

Impakti mjedisor eshte i lidhur ne menyre te drejtperdrejt edhe me rritjet e numrit te popullsisë , kjo e fundit rrit konsumin pra:

Impakti mjedisor = numer popullsisë x konsum

Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

Hartimi i Raportit te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis per aktivitetin e Spitalit perfshin pershkrimin e aktivitetit qe zhvillohet si dhe parashikon ndikimet e mundshme ne mjedis dhe planifikimin e masave zbutese ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit.

1.1 Informacion per qellimin e vnm dhe metodiken e zbatuar

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces qe siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Ndikimi – efekti i nje projekti qe ka ne mjedisin rrethues

Vleresimi – analiza qe i behet projektit

Mjedisi – elementet abiotike (kushtet fiziko- kimike te mjedisit) te kombinuara me elementet biotike (qeniet e gjalle te mjedisit).

Mjedisi fizik perbehet nga :

- qeniet e gjalla (flora , fauna)
- pjesa jo e gjalle (toke, ajer, uje)
- peizazhe (ndikimi vizuale)
- pasurit materiale
- pasuri kulturore (interes historik, turizem)

Mjedisi shoqeror ndahet ne :

- personal
- nderpersonal
- institucional (shendet, ekonomi, etj)

1.2 Pershkrim i qellimit dhe objektivave te VNM

Qellimi i VNM- se

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te aktivitetit nga **Spitali** . VNM nuk do te mbuloj cdo aspekt te nje efekti mjedisor te aktivitetit , me te njejtin nivel detajesh, theksi do te vihet ne efektet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjetër eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te Zhvillimit te aktivitetit te spitalit mbi mjedisin human.
- Analizimin e faktoreve pozitive e negative mjedisore dhenien e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne Mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

1.3 Objektivat e VNM

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve ne mjedis dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit te spitalit.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

Objektivat e tjera te studimit te paraqitur jane:

- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale negative te aktivitetit
- Permiresimet mjedisore te zones ku zbatohet aktiviteti dhe rreth saj.
- Perdorimin e burimeve natyrore ne menyre te qendrueshme ku respektohen dhe kerkesat e komunitetit te zones per rreth.
- Mbrojtjen e shendetit te njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;
- Lehteson informimin e vendim-marresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e aktivitetit
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peizazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale te projektit.

1.4 Legjislacioni Mjedisor ne Shqiperi

Ne Shqiperi fillesat e legjislacionit mjedisor shfaqen ne vitin 1993 , vit ne te cilin u hartua plani i pare i veprimit ne fushen mjedisore, qe perben dokumentin e pare zyrtar shqiptar mbi politikat mjedisore ne vend. Ky plan veprimi kombetar parachikonte se qeveria duhet te krijojte kuadrin ligjor , ekonomik dhe institucional per zgjidhjen e ceshtjeve mjedisore. Periudhen nga ky vit deri ne miratimin e Kushtetutes ne vitin 1998 mund ta konsiderojme si etapen e pare te zhvillimit te drejtes shqiptare te mjedisit. Mbas vitit 1998 e ne vijim eshte periudha e dyte e zhvillimit te se drejtes shqiptare te mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e perafimit me legjislacionin e Bashkimit European per mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar eshte ne persosje dhe pasurim te vazhdueshem dhe zhvillimi i tij nuk i eshte len rasteies, por ka si model dhe drejtues legjislacionin european te mjedisit. Duke qen se kushtetutat ravijezojne drejtimet e rregullimeve te ardhshme dhe me te hollesishme qe realizohen fillimisht me ligje dhe me pas me akte nenligjore edhe ne rastin e vendit tone Kushtetuta perben nje fillese dhe baze te rendesishme lidhur me rolin qe ka mjedisi per shoqerine dhe shtetit tone. Nisur nga permbajtja e neneve te Kushtetutes lidhur me fushen mjedisore mund te pohojme se fryma e Kushtetutes sone eshte ne perputhje me ate te shume kushtetutave te vendeve te tjera demokratike qe u kushtojne rendesi te nje niveli me te larte disa parimeve mjedisore, duke i ngritur ato ne nivelin e ligjit themelor te shtetit, sic jane e drejta per informimin e qytetareve dhe angazhimi e pergjegjesia per nje mjedis te pershtatshem per te jetuar jo vetem brezat e sotem por edhe ata ne te ardhmen.

- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per*

shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja.

- *Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”*
- *Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Ligji nr. 10006 date 23.10.2008 « Per mbrojtjen e Faunes se Eger »*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *VKM nr. 798 date 29.9.2010 “Per miratimin e rregullores per administrimin e mbetjeve spitalore”.*

1.5 Profili i subjektit

Godina e Spitalit “PETRO NAKO” u ndertua në fillim të viteve ’70 ndersa materniteti i Sarandës u ndërtua në kohën e Italisë Fashiste të Benito Mussolinit dhe asokohe Saranda quhej “Porto Eda” për nder të vajzës së Musolinit. Materniteti “ KRISTO KALIVOPULLI” eshte nen juridiksionin e spitalit i cili **eshte i rregjistruar prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve si institucion shteteror buxhetor, person juridik publik me emrin “DREJTORIA E SHERBIMIT SPITALOR SARANDE”, NIPTI K94327991U**

2- PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2.1 Qellimi i zhvillimit te aktivitetit

Qellimi i ketij aktiviteti eshte ofrimi i sherbimeve spitalore per te permiresuar shendetin duke ju gjendur sa me prane per te gjithë popullsine ne rajonin e Sarandes dhe jo vetem. Sherbimi shendetesor i ofrohet gjithë komunitetit me mjeket specialist te ketij spitali.

Vizioni I ketij spitali eshte rritja e besueshmerise se komunitetit, permiresimi i sherbimit shendetesor si dhe zhvillimi, vleresimi dhe perdorimi i teknikave te reja nga nje staf me vlera te larta mjekesore dhe shkencore.

2.2 Objektivat e zhvillimit te aktivitetit

- 1- Permiresimi i mbjenteve spitalore dhe pajisja me aparatura te reja ne sherbim te komunitetit.
- 2-Zbatimin e protokolleve te mjekimit dhe kodit te etikes.
- 3-Kualifikimin profesional te personelit mjekesor.
- 4-Zgjerimin e games se sherbimeve ne spital duke arritur standartet europiane.

Sherbimet spitalore qe ofrohen jane :

Shërbimi i urgjences
 Shërbimi i imazherisë
 Shërbimi i pediatrie
 Kirurgji e përgjithëshme
 Shërbimi i patologjisë
 Shërbim Obstetrik gjinekologji
 Patologji infektive
 Poliklinika e specialiteteve

Gjate viteve te zhvillimit te aktivitetit si dhe ne vitet ne vazhdim te funksionimit te spitalit, ky aktivitet do te jete konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.

Ky vleresim i ndikimit ne mjedis do te paraqes nje informacion te shkurter te aktivitetit ndikimet pozitive dhe negative ne mjedis dhe masat qe investitori do te marr per zbatimin e kriterëve te nevojshme per mbrojtjen dhe menaxhimin sa me racional te mjedisit.

2.3 Vendodhja ku ushtrohet aktiviteti

Spitali ndodhet ne : **Lagjja nr.3 , RRUGA “ONHEZMI”, SARANDE.**

Spitali ploteson te gjitha kushtet higjenosanitare.

Furnizimi me uje sigurohet nga rrjeti ujesjelles Sarande ne baze te kontrates se lidhur, spitali gjithashtu disponon nje depo rezerve per nevojat imediate.

Energjia elektrike sigurohet nga rrjeti i zones ne rast te mungeses se saj vihet ne pune gjeneratori. Funkcionon sistemi i ventilimit dhe ngrohjes se ambienteve spitalore, me kaldaj lenda djegese sigurohet nga shoqeria e kontraktuar ne baze te kontrates qe spitali ka lidhur.

Jane marr masat per mbrojtjen nga zjarri. Ne vende te dukshme jane te instaluar hidrantet si dhe funksionojn daljet emergjente.

Nga ana e personelit jane marr masat per parandalimin dhe mbrojtjen nga infeksionet spitalore.

Shkallet midis kateve dhe koridoret kane hapësira te mjaftueshme per levizje pa probleme.

Spitali eshte i pajisur me ndricim te pershtatshem per te gjitha ambientet si dhe funksionon sistemi i ventilimit te ajrit te fresket ne dhomat e pacienteve si dhe ne ambientet e tjera te spitalit.

Mobiljet dhe pajisjet jane te krijuara dhe ndertuara per te thjeshtesuar pastrimin e tyre si dhe lehtesi perdorimi.

Spitali ploteson te gjitha kriteret e ushtrimit te veprimtarise sipas rregullave dhe legjislacionit ne fuqi.

Kriteret per personelin mjekesor

Spitali siguron se personeli mjekesor dhe jo mjekesor ka arsmin dhe kualifikimet e nevojshme sipas vendit te punes qe ushtron. Spitali ka rregullore te brendshme ku percaktohen detyrat dhe pergjegjesit e sicilit punonjes sipas vendit te punes qe ushtron.





2.4 Repartet ne spital jane;

Kirurgjia

Reparti i terapise intensive ofron nje sherbim te specializuar, cilesor te urgjencave te ndryshme. Perfshihen urgjenca kirurgjikale, operacione te planifikuara , politrauma, urgjenca : abdominale, kranio-cerebrale, te extremiteteve, fraktura, semundje cerebrovasculare te renda , koma , infarkte, shock kardiogjen , crregullime ritmi, patologji infektive te renda , patologji pulmonare soturim te ulet O2 , respracion te drejtuar, obs-gjinekologjike etj

Laboratori

Laboratori i Spitalit Sarande eshte njesi e rendesishme funksionale ne aktivitetin ekzaminues, diagnostikues dhe trajtimin e patologjive te ndryshme.

Aktiviteti i laboratorit konsiston ne nje numer te madh ekzaminimesh qe ky laborator kryhen ne sherbim te komunitetit.

Gjate viteve te fundit ne Laboratorin e Spitalit Sarande jane vene ne pune aparatura te standarteve te larta bashkekohore.

Patologjia

Reparti i sherbimit te Patologjise Ofron

- Konsultat me mjeket specialist per pacientet e hospitalizuar shtrimet e reja
- Vizitat e pacienteve te hospitalizuar.
- Ekografi kardiake per pacientet ambulatory me rekomandim nga mjeku specialist I Poliklinikes Qendrore.

Pedriatia

Pedriatia funksionon si pediatri e pergjitheshme dhe si pediatri infektive. Ne kete repart punojne mjekë pediatër me nenspecialitete:

- Reanimacion pediatrik
- Pediatër alergolog
- Pediatër nefrolog
- Pediatër infeksionist
- Pediatër hematolog

- Peditër i pergjithëshem

Urgjenca

Krijimi i repartit te urgjences eshte prioritet i punes per permisim te kapaciteteve operacionale te ekipit mjekesor per te nderhyre ne kohe per pacientet me semundje akute.

Urgjenca e Spitalit ka dhomat per pacientet. Brenda ambjenteve ndodhet dhoma e infermiereve qe monitoron te semuret, dhoma e kryeinfermierit , dhoma e mjekut roje

Prane ketij spitali punojne 29 mjeke, 100 infermiere dhe laborant, 14 administrate dhe 57 te tjere.

3- PERSHKRIMI I RAJONIT

3.1 Pozicioni Gjeografik

Rrethi i Sarandës ndodhet në ekstremin më jugor të Shqipëisë, atje ku regjistrohet edhe gjerësia gjeografike prej 38-39 (konispol). Ajo kufizohet në veri me Vlorën, në lindje me Delvinën dhe Gjirokastrën, në jug me Greqinë kurse në perëndim më detin Jon. Saranda është pika më jugore e Shqipërisë, ajo është e shtrirë në mes kodrash që bien në brigjet e detit Jon. Sipërfaqja e Sarandës është rreth 2200 ha, dhe shtrihet nga kepi i Dentës deri në kepin e Paledhës në veri perëndim.

Rrethi i Sarandës ka një relief përgjithësisht fushor, i cili përbëhet nga: pjesa jugore e maleve bregdetare që shtrihen nga Borshi deri në gjirin e Ftelias, fushat e Vrugut, fusha e Vrinës dhe kodrat e Sarandës, Lëkurësit, Ksamilit, Butrintit e Konispolit. Të gjitha këto njësi përbëjnë pjesën jugore të Rivierës Shqiptare në të cilën bien në sy gjiret e shumta, plazhet, bregdeti shkëmbor, kodra me ullinj dhe agrume, malet që qarkojnë peizazhin. Territori i Sarandës përshkohet nga lumenjtë e Kalasës, Bisticës dhe Pavllës që derdhen në detin Jon. Bistrica është e famshme edhe për troftën e saj (Salmo Fario) dhe troftën e kultivuar (Salmo Irideus). Në hidrografinë e Sarandës bën pjesë edhe liqeni i Butrintit i cili është një nga liqenet më të mëdha detare të Shqipërisë. Liqeni i Butrintit është mjaft i pasur me specie detare, dhe në ujërat e tyre tashmë është krijuar tradita e kultivimit të midhjeve. Kushtet e relievit, gjerësia gjeografike dhe klima subtropikale krijon kushte shumë të mira për kultivimin e agrumeve dhe ullirit.

Bregdeti shqiptar i detit Jon, shtrihet prej kepit te Stillos ne jug, deri ne kepin e Gjuhezes ne veri, me nje gjatesi prej rreth 170 km. Brigjet e tij formojne nje nga bregdetet me piktoresk te pellgut te Mesdheut, qe njihet edhe me emrin Riviera Shqiptare. Ujerat e detit Jon pergjate bregdetit te Sarandes, jane te pastra, me perjashtim te sektoreve te vecuar me shenja te ndotjes, si pasoje e aktivitetit te njeriut, sidomos ndotje verehet ne portin e Sarandes dhe pergjate shetitores te

qytetit.

Liqenet jane pjese e rendesishme e ofertes natyrore te ketij rrethi per zhvillimin e turizmit. Liqenet kryesore te ketij rajoni jane: Liqeni i Butrintit dhe i Rrezes (ndodhet ne lindje te liqenit te Butrintit). Liqeni i Butrintit eshte me i madhi e me i rendesishmi. Ai ndodhet ne pjesen jugore te rrethit te Sarandes dhe ka origjine tektonike. Brigjet veriore dhe jugore jane te uleta per shkak te prurjeve te lumenjve Pavlla e Bistrica. Ana perendimore e liqenit eshte shkembore me shkurre te shumta, ndersa ajo lindore ka disa plazhe ranore te bukur.

Ne bregun jugperendimor gjenden rrenojat e qytetit antik te Butrintit, cka e ben kete liqen lehtesisht te vizitueshem nga turistet. Liqeni i Butrintit ka kontakt me detin Jon nepermjet Kanalit te Butrintit (te Vivarit). Ky kanal eshte i gjate rreth 3 km, i gjere 120-160 m si dhe ka thellesi mesatare 6-8,8 m. Lumenjte kryesore qe gjenden ne rrethin e Sarandes jane: Pavlla, Bistrica, Kalasa me deget e tyre.

3.2 Klima

Klima është tipike mesdhetare. Saranda ka 270-300 ditë me diell në vit. Si cdo lloj tjetër klime tipike mesdhetare ajo karakterizohet nga vera e thatë dhe e nxehtë dhe dimri i butë e i lagësht. Temperaturat më të larta në verë janë 25-27 C dhe në dimër 0-2 gradë. Temperatura mesatare vjetore është 17- 18 gradë në dimër. Temperaturat e ujit janë mesatarisht 16.3 gradë në dimër dhe 24.2 gradë në verë. Sasia e reshjeve varion 1.600-1.800 mm shi në vit. Kjo lloj klime gjithëvjetore.

3.3 Ekonomia

Saranda është një qendër e rëndësishme turistike në Shqipëri. Burim kryesor i të ardhurave është turizmi dhe emigracioni. Pozita e saj gjeografike favorizon shumë bujqesinë dhe blegtorinë.

3.4 Flora dhe Fauna

Flora dhe fauna ne rrethin e Sarandes perben interes per turistet qe kane qellime studimi, mjedisore, gjuetie etj. Me vlerat e vecanta qe ajo ka perben nje pjese te rendesishme te ofertes turistiko-natyrore. Kushtet e favorshme klimatiko-tokesore te Sarandes, kane bere qe ne te, shkalla e biodiversitetit te jete shume e larte. Prania e detit Jon dhe e liqenit te Butrintit, bejne qe krahas botes se gjalle qe ekziston ne toke, te jete e pranishme me llojshmerine e saj edhe bota e gjalle ujore. Perhapja e bimesise eshte e kushtezuar nga disa faktore, sic jane: temperatura, llojet e tokave, dhe ndikimi i njeriut etj.

Bimesia e rajonit të Sarandës është e larmishme. Në fushat e saj mbillen gati të gjitha kulturat bujqesore. Një pasuri të madhe përbejnë pyjet që nga Drovjani, Muzina, Delvina, Rrezoma, Grava Karoqi, Konispoli, Borshi, Coraj etj dhe zene afro 18% të sipërfaqes. Në lartësi të ndryshme përveç drurëve frutore si kumbulla, pjeshka, fiku, arra, bajamja etj rriten dhe drurë të shumtë si lisi, ilqja, gështenja, mareja, dafina, dellinja e kuqe, shqopa, pishat etj. Një vend me rëndësi zene zonat e makjeve dhe shkurreve dhe shqerimet tipike mesdhetare me zhvillim të vrullshëm në stinën e pranverës. Në trevën e Sarandës rriten edhe bimë të rralla si xhinxhibuni, bima e piperit, bambute etj. Saranda zë vendin e parë në Shqipëri për prodhimin e agrumeve, të tretën për ullirin, kurse vreshtat dhe pemet frutore zene 33% të sipërfaqes. Një pasuri të madhe bimore kanë edhe ujërat e detit Jon me algat dhe livadhet nënujore shumë të bukura, ku nuk mungojnë koralet etj.

Fauna

Edhe bota shtazore është e pasur e shumëllojshme. Përveç kafshëve shtëpiake si lopa, delja, dhia, kali, pulat etj në pyjet dhe rrethinat e Sarandës gjenden një larmi kafshësh të egra të lakmueshme për gjueti si derri i eger, lepuri, cakalli, dhelpra, ujku, sorkadhja, thelleza, mellenja e zeze, cafkat, roast etj. Të pasura e të ruajtura janë rezervatet e gjuetisë në pyllin e Butrintit në Stillo, Corraj, Muzinë.

Saranda gjithashtu ka një shkallë të lartë të biodiversitetit të amfibeve që në disa raste nuk mund të krahasohet me asnjë rreth tjetër të Shqipërisë. Ka lloje që jetojnë në Sarandë duke pasur kufirin me veriperëndimor të arealit të tyre. Të tilla janë breshka malore, hardhuca e barit apo gjarpri i reres. Ka lloje amfibesh të zbuluar vitet e fundit, sic është bretkosa e Epirit (*Rana epeirotica*), një specie subendemike me vlerë bioekologjike. Ky lloj amfibi ka përhapje gjeografike shumë të vogël. Ai gjendet vetëm në ultësirën e Sarandës dhe në një pjesë të vogël të Greqisë V-P. Prania e detit Jon si dhe pasuritë e shumta hidrografike i kanë dhënë kësaj zone një faunë ujore të pasur. Në ujërat e detit Jon jetojnë peshq të ndryshëm si sardelja, qefulli, levreku, koca, dentali, skumbria, ngjala e detit etj., si dhe butake detare, si midhja që kultivohet në liqenin e Butrintit.

3.5 Turizmi

Zhvillimi ekoturistik mbështetet në objektet, monumentet dhe ekosistemet me vlerë të vecanta natyrore. Formacionet gjeologjike, larmia e peizazheve, ujërat, kushtet klimatike dhe prania e bimesisë së vecantë, ndikojnë në ngritjen e komplekseve të ndryshme. Gjithashtu këto pasuri natyrore ndikojnë në rritjen e numrit të turistëve, pasi ato përmbajnë vlerë turistike, shkencore, kulturore e didaktike. Për vlerat e përmendura më sipër disa prej tyre kanë marrë edhe statusin e monumentit të natyrës me vendim të Këshillit të Ministrave. Lista e monumenteve të natyrës, tregon se në rrethin e Sarandës kemi një ofertë ekoturistike mjaft të pasur. Në ofertën ekoturistike bëjnë pjesë objektet e natyrës së gjallë e jo të gjallë.

Ne objektet e natyres se gjalle bejne pjese pemet dhe masivet drusore. Nder pemet me vlera te vecanta permendim rrapet. Ato jane te vendosura ne qender te disa fshatrave dhe kryesisht prane burimeve. Pasurite natyrore ne rrethin e Sarandes jane vetem nje pjese e potencialeve ekoturistike te rrethit. Turistet jane te interesuar qe te shikojne apo te njihen me kuriozitetet e natyres, prandaj i vizitojne ato me kenaqesi, duke paguar edhe taksa per realizimin e ketyre vizitave. Hidrografia e zones paraqitet ne gjendje mjaft te mire. Ujerat kane nje perdorim te gjere e japin nje ndihmese pozitive ne zhvillimin e turizmit, te prodhimit te energjise, ne ujitjen e tokave, ne furnizimin e popullsisë, ne peshkim etj. Ujerat e zones se Sarandes, jane te kthjellta dhe me nje kaltersi tipike, gje e cila e bene rrethin e Sarandes te vecante dhe mjaft terheqes.

4- VLERESIMI I NDIKIMEVE

4.1 Ndikimet e mundshme ne shendetin e njerezve

Zhvillimi i aktivitetit spitalor nuk ka ndikime negative mbi shendetin e banoreve te zones, ky aktivitetet me sherbimet qe ofron ju vjen ne ndihme pacienteve te cilet kane probleme shendetesore.

4.2 Ndikimet ne toke

Per mbetjet spitalore qe krijohen nga zhvillimi i aktivitetit eshte kontraktuar shoqeria MEDI – TEL shpk per terheqjen dhe trajtimin e tyre. Mbetjet urbane qe krijohen nga aktiviteti i perditshem i personelit dhe pacienteve grumbullohen ne kontenieret perkates dhe me pas largohen nga shoqeria e kontraktuar per largimin e mbetjeve jo te rrezikshme.

Mbetjet spitalore mund te shkaktojne infeksione nese vijne ne kontakt me lekuren, syte, ajrin, gojen ose nese ne menyra te ndryshme depertojne ne trupin e njeriut.

Ndaj fillimisht i gjithe stafi i pavionit njihet me rendesine e mbetjeve qe prodhohen ne repart, grumbullimin e tyre dhe ndarjen e rregullt sipas kutive te vecanta.

4.3 Ndikimet ne uje

Nuk do te kemi shkarkime ne mjedisin uhor prites te cilat mund te ndryshojne cilesine e ujerave nentokesor apo siperfaqesore. Uji qe perdoret nga stafi dhe pacientet e shtruar per nevoja higjenosanitare , uji per ujitjen e lulishtes do sigurohet nga rrjeti i zones dhe do ti bashkohet kanalizimeve po te zones. Keto ujera nuk permbajne elemente ndotes.

4.4 Ndikimet ne ajer

Zhvillimi i aktivitetit të spitalit nuk ka emetim të gazeve ndotes në atmosferë duke qenë se është një aktivitet shërbimi i cili nuk përdor lëndje djegëse të cilat çlirojnë gaze ndotes.

4.5 Ndikimet nga zhurmat

Vet aktiviteti kërkon një ambient të qetë pa zhurmë duke qenë se ka të bëjë me trajtimin e pacientëve të sëmurë. Të vetmet zhurma që mund të krijohen janë nga mjetet që kalojnë në afërsi të spitalit duke qenë se ndodhet buze rruges, por këto rrugë nuk karakterizohen nga ndonjë trafik i rënduar dhe krijimi i zhurmave nga këto mjete nuk përmben problem shqetësues për pacientët. Zhurma të perkoheshme kemi dhe nga autoambulancat të cilat sjellin raste të urgjente në spital.

4.6 Ndikimet në florë dhe faunë

Ky aktivitet nuk sjell shkatërrim të habitatëve natyrorë. Zona paraqitet me një florë dhe faunë jo shumë të pasur.

4.7 Ndikimet në klimë

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime mbi klimën. Gjate zhvillimit të aktivitetit nuk priten ndryshime të dukshme klimatike, si në drejtim të permiresimit ashtu edhe në atë të perkeqesimit të saj.

4.8 Ndikime mbi trashëgimë kulturore

Zona ku ushtron aktivitetin spitali nuk njihet si zonë e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore, pra nuk kemi ndryshime apo demtime të saj duke qenë se nuk ekziston në këtë territor.

4.9 Ndikimet me natyrë nderkufitare

Zhvillimi i aktivitetit ndodhet brenda territorit të vendit tënde dhe nuk ka ndikime me natyrë nderkufitare.

5. MASAT QE DUHEN MARR PER ELEMENIMIN / MINIMIZIMIN E NDOTJEVE

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate zhvillimit te aktivitetit.

5.1 Masat per Shkarkimet ne uje

Uji qe perdoret per nevojat vetjake nga personeli i spitalit si dhe pacientet, uji qe do te perdoret dhe ambientet e tjera per pastrimin e tyre sigurohet nga ujesjellesi Sarande ne baze te kontrates qe eshte lidhur, ujerat shkarkuese nuk permbajn elemente ndotes per mjedisin ujqor prites. Keto ujera do i bashkohet rrjetit te kanalizimeve te qytetit.

5.2 Masat per Depozitimet ne toke

Mbetjet spitalore te rrezikshme ruhen ne magazine te vecante derisa terhiqen nga firma e kontraktuar. Koha mesatare e qendrimit eshte 7 dite. Mbetjet urbane qe vijne si rezultat i konsumit te produkteve te ndryshme ushqimore ose jo, terhiqen nga shoqeria e kontraktuar nga spitali per largimin e mbetjeve jo te rrezikshme.

Persa i perket menaxhimit mjedisor per mbledhjen e mbetjeve brenda secilit repart, ndarjen e tyre sipas kutive perkatese dhe izolimin e kutive pergjegjes ne baze te rregulloreve te brendshme te menaxhimit te mbetjeve per secilin repart eshte i gjithe stafi qe mbulon repartin. Duke filluar qe nga shefi i repartit, kryeinfermieri, infermieret dhe sanitarja e turnit secili ka detyrat perkatese.

5.3 Masat ndaj zjarrit

Rreziku ndaj zjarrit eshte prezent ne te gjitha mjediset, zjarri eshte nje djegie qe zhvillohet ne menyre te pakontrolluar ne kohe dhe hapesire , pra eshte nje reaksion kimik ndermjet nje trupi te djegshem dhe nje trupi qe djeg. Per te ulur shkallen e rrezikut ndaj zjarrit dhe sigurimin e mbrojtjen e personave nga ana e spitali jane marr masat ndaj mbrojtjes se zjarrit.

5.4 Masat ndaj zhurmave

Burim zhurme është çdo makinë, instalim, mjet pune, mjet transporti, proces teknologjik, që lëshon zhurmë. Masat e mbrojtjes nga zhurma përbëjnë tërësinë e ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi. Vet aktiviteti kerkon nje ambient te qete pa zhurma duke qen se ka te bej me trajtimin e pacienteve te semure.

5.5 Masat estetike dhe ekologjike

Masat estetike dhe ekologjike konsistojne ne rregullimin e ambientit te jashtem me lule dekorative per te krijuar nje ambient te kenaqshem per syrin e njeriut. Ne perimetrin perreth spitalit si dhe ne sheshin ku eshte edhe hyrja kryesore eshte krijuar ambient i gjelber per te cilin

tregohet nje kujdes i vecante nga punonjesit per mirembajtjen e tij. Krijimi i lulishtes eshte mjaft i rendesishem per pacientet qe ndodhen ne kete spital.

6. PROGRAMI I MONITORIMIT

Monitorimi i mjedisit eshte sistemi i mbikqyrjes dhe studimit te kushteve mjedisore. Monitorimi perfshin marrjen e mostrave ne ajer, toke, uje per te percaktuar nese ndonje faktore fizik apo biologjik ndikon negativisht ne ekosistemet apo habitatet natyrore. Monitorimi eshte proces qe realizohet per te mbrojtur mjedisin dhe shendetin e njerezve.

Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet ne se operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Bazuar ne kuadrin ligjor ekzistues te gjithë aktivitetet te cilet veprojne ne mjedis monitorohen persa i perket ndikimit qe ato kane ne mjedis. Ky monitorim behet ne menyre qe te nxjerrim konkluzione sa me te sakta per te kryer nderhyrjet e nevojshme.

7. PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE

Problemet e gjenerimit te mbetjeve dhe administrimit te tyre jane zgjidhur duke kontraktuar shoqerine e cila merrret me terheqjen e mbetjeve spitalore dhe trajtimin e metejshe me tyre. Per terheqjen dhe menaxhimin e mbetjeve te rrezikshme nga ana e Spitalit eshte lidhur nje kontrate me shoqerine MEDI-TEL shpk. Mbetjet urbane qe krijohen nga aktiviteti i perditshem i personelit hidhen ne vendin e caktuar per kete qellim , terhiqen nga shoqeria e kontraktuar dhe me pas largohen per ne vendin e caktuar nga Bashkia Sarande.

Grumbullimi i mbetjeve ne magazine te vencant deri ne momentin e terheqjes nga shoqeria e kontraktuar eshte pergjegjesi e spitalit.

Per te shmangur dhe menaxhuar sa me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga elementet e pershkruar me siper, spitali nepermjet personelit te tij harton dhe zbaton nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis. Realizimi me sukses i ketij plani sjell nje sere perfitimesh per shoqerine te tilla si: ushtrimi i veprimtarise ne perputhje me ligjet dhe rregulloret, mardhenie te mira me publikun dhe ambientalistet, shmangia e penaliteteve nga organet e kontrollit te mjedisit etj.

8.KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Rekomandime.

- Te pastrohen dhe mirembahen kanalet e drenazhimit te ujerave perreth perimetrin te objektit
- Te kontrollohet kompletimi me mjete mbrojtese nga zjarri
- Te behet kujdes ne ndarjen e mbetjeve te rrezikshme qe ne burim
- Te monitorohen kushtet ne te cilat ruhen mbetjet e rrezikshme deri ne momentin e terheqjes se tyre nga firma e kontraktuar

Perfundime

- Zhvillimi i aktivitetit te spitalit ka ndikime te rendesishme pozitive duke qen se i vjen ne ndihme popullsise per problemet e tyre shendetesore
- Mbetjet e rrezikshme qe krijohen nga zhvillimi i aktivitetit paketohen dhe ruhen ne magazine e posacme deri ne momentin e largimit te tyre.
- Ndarja e mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme behet qe ne burim
- Furnizimi me uje te pijshem do te sigurohet nga rrjeti ekzistues i zones ne baze te kontrates te lidhur me ujesjellesin Sarande
- Furnizimi me energji elektrike do te sigurohet nga rrjeti ekzistues qe mbulon zonen duke plotesuar te gjitha kushtet teknike ne baze te kontrates se lidhur me OSHEE.
- Zhvillimi i aktivitetit nuk gjeneron zhurma ne mjedis , vet aktiviteti kerkon nje ambjent te qete pa zhurma duke qen se ka te bej me trajtimin e pacienteve te semure .
- Aktiviteti nuk gjeneron ujera te ndotura, uji qe sigurohet nga ujesjellesi perdoret per nevoja vetjake dhe higjenosanitare.